



GJYKATA
E RRETHIT
GJYQËSOR
SHKODËR



GJYKATA
E RRETHIT
GJYQËSOR
SHKODËR

Për çdo informacion lidhur me këtë projekt,
mos hezitoni të kontaktoni në adresën:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër,
Rruga “Don Bosko”.

Tel/Fax: +355 (0) 22243591

WebPortal: http://www.gjykata.gov.al/portal_DCSH/

E-mail: Njoftime.GjykataShkoder@gjykata.gov.al

Tetor 2016. Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Programi i USAID-it Drejtësi për të Gjithë. Brendia tij nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, USAID-it apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PROJEKTI “PËR NJË DREJTËSI PA VONESA”

**Qytetarë, avokatë, prokurorë, përfaqësues institucionesh
qendrore e lokale, ekspertë të fushave të ndryshme,
bëhuni pjesë e nismës “Për një drejtësi pa vonesa”!**

Të gjithë së bashku, t'u themi ndal vonesave të panevojshme në proceset gjyqësore!

Në fushën e së drejtës, drejtësia e vonuar është një drejtësi e mohuar. Për fat të keq, vonesat dhe tejzgjatjet e proceseve gjyqësore ndodhin jo rrallë në gjykatat shqiptare. Me vendosmërinë për ta ndryshuar këtë situatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër po ndërmerri një sërë hapash konkrete për të shmangur vonesat e panevojshme në gjykim. Duke filluar nga muaji tetor 2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkon të informojë, këdo që i drejtohet asaj, si më poshtë vijon:

- Gjykata planifikon seancat me përgjegjshmëri dhe në bashkëpunim me palët. Seanca e planifikuar dhe për të cilën palët janë njoftuar apo kanë marrë dijeni kur gjykata vihet në dijeni paraprakisht të një shkaku që e pengon zhvillimin e duhur të saj (produktivitetin) do të anulohet. Gjyqtari paraprakisht njofton palët për seancën e re dhe shkakun e anulimit të seancës së planifikuar më parë.

- Çdokush i njoftuar nëpërmjet fletëthirrjes është i detyruar t'i përgjigjet gjykatës dhe të paraqitet pranë saj. Në rast mosrespektimi të kësaj kërkesë, gjykata ka të drejtë të vendosë gjobë ose zhvillimin e gjykimit në mungesë, sipas të drejtave që i jep ligji.

- Pas kryerjes së veprimeve përgatitore, gjykata do të kalojë çështjen në seancë gjyqësore brenda të njëjtës ditë aty ku është e mundur.

- Prokurorët dhe avokatët duhet të jenë gjithmonë të pranishëm në seancë.

- Gjykata nuk do të pranojë kërkesa për shtyrje seance të pashoqëruara me prova të plota dhe bindëse që vërtetojnë shkakun e arsyeshëm të kërkesës për shtyrje. Qenia në një gjykim tjetër nuk do të pranohet nga gjykata si shkak i arsyeshëm pa i bashkëngjitur kërkesës fletëthirrjen që i është dërguar nga gjykata tjetër apo dokument tjetër.

- Pretendimet përfundimtare të paraqiten nga prokurori dhe avokati në një seancë sidomos në gjykimin e drejtpërdrejtë dhe të shkurtuar. Në rast të mosparaqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga Prokuroria brenda të njëjtës seancë, të shtyhet seanca brenda një afati sa më të shkurtër, në të njëjtën ditë ose ditën pasardhëse.

- Avokatët duhet të respektojnë të gjitha rregullat lidhur me elementët e kërkesëpadisë të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Ata duhet të përmbushin brenda datës së seancës së radhës.

- Institucionet qendrore dhe vendore duhet të sigurojnë përfaqësuesit e tyre në gjykim. Kthimi i përgjigjes brenda zhvillimit të seancës së radhës të çdo informacioni ose provave të kërkuara nga palët në proces ose në të kundërt t'i jepet palës me shkrim shkakun i refuzimit ose i mosdhënies. T'i përgjigjen me korrektësi dhe brenda afatit çdo shkresë të dërguar nga gjykata.

- Zbatimi i sanksioneve nga gjykata ndaj palëve të cilat shkaktojnë zvarritjen e gjykimit në mënyrë të pajustificuar si dhe njoftimi i organeve eprore. (p.sh. mosparaqitja e të dhënave/dokumenteve brenda datës së seancës së caktuar).

- Zyra postare Shkodër, do të realizojë njoftimet sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale (rasti kur pala refuzon marrjen, ekzistenca e një dëshmitari), duke zhvilluar trajnim të punonjësve/postierëve të postës për rregullat procedurale të njoftimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër u bën thirrje qytetarëve, institucioneve qendrore e lokale dhe ekspertëve e profesionistëve ligjorë që të bëhen pjesë e kësaj nisme, duke mos lejuar zvarritjen e proceseve gjyqësore dhe duke kontribuar në përfundimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm!

Pjesëmarrja dhe angazhimi aktiv i të gjithëve është thelbësor për dhënien e drejtësisë në kohë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër mbështetet në këtë projekt nga këta partnerë dhe institucione:



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



**AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION**